



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. Prot. 418, datë 16.02.2023

Nr. Prot. 338, datë 16.02.2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS (këtej e tutje "UPT"), përfaqësuar nga Prof. Dr. Andrea Maliqari, Rektor i UPT, veprimtaria e të cilit mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

dhe

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE (këtej e tutje "INSTAT"), përfaqësuar nga Znj. Elsa Dhuli, Drejtor i Përgjithshëm, veprimtaria e të cilit bazohet në Ligjin nr. 17/2018 "Për statistikën zyrtare";

Duke qenë se Palët:

Njohin faktin që kjo marrëveshje përbën shprehje të vullnetshme të qëllimit midis palëve nënshkruese për të punuar së bashku për të promovuar efikasitetin e njohurive.

Synojnë që marrëveshja të mbështesë një sërë aktiviteteve dhe të promovojë vendosjen e objektivave dhe procedurave të bashkëpunimit të ndërsjellë për shkëmbimin e informacionit akademik dhe informacione të tjera duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe mirëbesimit.

Vlerësojnë se marrëveshja krijon një kornizë dhe kushte të përgjithshme për bashkëpunimin efikas.

Marrin në konsideratë që marrëveshja do të përforcojë, promovojë dhe zhvillojë bashkëpunimin e tyre reciprok, nëpërmjet kryerjes së praktikës profesionale të studentëve të UPT pranë INSTAT.

Konfirmojnë të marrin përsipër që të vendosin në dispozicion të njëra-tjetrës të gjitha burimet njerëzore dhe materiale, në arritjen e qëllimeve që parashikon kjo marrëveshje, në përputhje me interesat institucionale, mundësitë dhe kapacitetet përkatëse.

Afirmojnë vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje.

kanë rënë dakord të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi, në vijim të quajtur "Marrëveshje".

Neni 1

Objekti

Palët e kësaj Marrëveshje, duke vepruar mbi bazën e dispozitave të saj, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi, do të përpiqen të përforcojnë, promovojnë dhe zhvillojnë bashkëpunimin e tyre reciprok mbi bazën e barazisë dhe përfitimit të përbashkët në çdo fushë të parashikuar në këtë Marrëveshje.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

1. Kjo Marrëveshje synon të sigurojë bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve nënshkruese, brenda kompetencave ligjore, për modernizimin e proceseve të prodhimit statistikor, rritjen e kuptueshmërisë dhe ndërgjegjësimit në statistika si dhe lehtësimin e proceseve kërkimore shkencore.

2. Palët nënshkruese marrin përsipër që në përputhje me interesat institucionale, mundësitë dhe kapacitetet përkatëse, të vendosin në dispozicion të njëra-tjetrës të gjitha burimet njerëzore dhe materiale, për arritjen e qëllimeve që parashikon kjo marrëveshje.

3. Fushat kryesore të bashkëpunimit do të jenë për:

- a) Përgatitjen e kurrikulave të mësimdhënies dhe pasurimin e atyre ekzistuese, të cilat lidhen me statistikat zyrtare;
- b) Vënien në dispozicion të kapaciteteve që disponon INSTAT për kryerjen e praktikës dhe *traineeship*-eve nga studentët e UPT, sipas kërkesave të fakulteteve përkatëse;
- c) Rritjen e aftësive dhe njohurive të studentëve në proceset e përpunimit dhe analizës së statistikave zyrtare;
- d) Pjesëmarrjen e përfaqësuesve të UPT në Grupin Akademik të Statistikave Zyrtare;
- e) Pjesëmarrjen e stafit të INSTAT në proceset e mësimdhënies në fakultetet e UPT, në bazë të ekspertizës që zotërojnë, si dhe interesit që shprehin njësitë përbërëse të UT-së në përputhje me kriteret dhe afatet e caktuara nga çdo njësi përkatëse, në bazë të legjislacionit në fuqi;
- f) Përfshirjen e studentëve në proceset e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave gjatë kryerjes së censeve në Republikën e Shqipërisë;
- g) Vënien në dispozicion, aty ku është e mundur, të ambienteve që disponon UPT dhe fakulteteve të tij për kryerjen e trajnimeve të stafit të terrenit në kuadër të zhvillimit të censeve në Republikën e Shqipërisë.

11

Neni 3

Kushtet e Bashkëpunimit

1. Palët nënshkruese marrin përsipër pasurimin e kurrikulave dhe ngritjen sistemeve të mësimdhënies me qëllim prodhimin e statistikave zyrtare në përputhje me standardet e statistikave evropiane.

2. INSTAT merr përsipër të mbështesë studentët dhe profesoratin në punën kërkimore-shkencore në lidhje me statistikën në fusha të ndryshme, nëpërmjet ofrimit të trajnimit mbi teknikat e avancuara të përpunimit statistikor dhe metodave statistikore si dhe duke i pajisur me dëshmi/certifikatë bazuar në programin e ndjekur.

3. UPT angazhohet për përfshirjen e stafit të INSTAT-it si pedagogë në kurrikulat mësimore të UPT-së.

4. Në kuadër të aktiviteteve trajnuese që organizohen për qëllime të rritjes së kapaciteteve profesionale të statistikienëve, INSTAT merr përsipër të ftojë edhe profesoratin e fakulteteve të UPT, në varësi të temave dhe kurrikulave.

5. Për rritjen e besueshmërisë në statistikën zyrtare, UPT kontribuon në dhënien e konsulencës së specializuar në fushën e IT dhe fusha të tjera të veprimtarisë që ai mbulon.

6. Në interes të zhvillimit të fushave specifike statistikore, ky memorandum shërben si mbështetje për nënshkrimin e marrëveshjeve specifike të bashkëpunimit me fakultetet e UPT.

Neni 4

Pronësia Intelektuale

Kur si rezultat i bashkëpunimit të kryer në përputhje me këtë Marrëveshje, realizohen produkte që janë objekt i së drejtës mbi pronësinë intelektuale, ato do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Konfidencialiteti dhe konflikti i interesit

1. Palët nënshkruese angazhohen të marrin të gjitha masat për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe informacionit për të cilin marrin dijeni gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje, në respektim të nenit 31 të ligjit nr. 17/2018 "Për statistikën zyrtare" dhe akteve të tjera ligjore në fuqi që mbrojnë konfidencialitetin e të dhënave personale.

2. Në çdo rast, bashkëpunimi i ndërsjellë gjatë të kësaj Marrëveshje do të udhëhiqet nga parimet e etikës profesionale dhe shmangies së konfliktit të interesit sipas legjislacionit në fuqi.

3

Neni 6 Komunikimi

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm në të gjitha nivelet. Me qëllim përmbushjen e objektivave të kësaj Marrëveshje, secila palë do të caktojë një person si person kontakti për komunikimin midis tyre dhe përcjelljen e problematikave sipas rastit.

2. Personat e kontaktit për secilën palë, në kuadër të zbatimit të kësaj Marrëveshje janë:

a) Për INSTAT:

Z./Znj. Helda Curma (Mitre), Drejtor i Drejtorisë Përgjithshme të Grumbullimit të të Dhënave dhe TI,

e-mail hmitre@instat.gov.al

b) Për UPT:

Prof. Dr. Luella Prifti, Drejtues i Departamentit të Inxhinierise Matematike, FIMIF.,

e-mail: l.prifti@fimif.edu.al

Neni 7 Kufizimet e Marrëveshjes

1. Të dy palët bien dakord që realizimi i veprimtarive me interes të përbashkët të kryhet në varësi të përparësive, planifikimit paraprak, burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion.

2. Për çdo veprimtari tjetër, që përputhet me frymën e kësaj Marrëveshjeje, palët kanë të drejtë të konkludojnë mbi mënyrën e realizimit të bashkëpunimit.

3. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve.

4. Nëse nga bashkëpunimi ndërmjet institucioneve bazuar në parimet e mësipërme, lind nevoja për financimin e projekteve të përbashkëta, të dy institucionet do të rregullojnë këto raporte me Marrëveshje të veçanta financiare të cilat do të jenë pjesë integrale e kësaj Marrëveshje bashkëpunimi.

5. Palët bien dakort që të ruajnë dhe të respektojnë integritetin reciprok.

Neni 8 Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga Palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.

Neni 9 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshje, do të zgjidhet me mirëkuptim dhe bashkëpunim mes palëve.

Neni 10
Dispozita të Fundit

1. Megjithë sa është parashikuar në nenin 8, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë duke lajmëruar në formë të shkruar vullnetin për ndërprerjen e saj. Në këtë rast, Marrëveshja përfundon 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së këtij njoftimi.

2. Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, një për secilën palë, ku të gjithë tekstet janë njëloj të vlefshëm.

**Për Universitetin Politeknik të Tiranës
(UPT)**

Prof. Dr. Andrea Maliqari

Rektor



Për Institutin e Statistikave (INSTAT)

Dr. Elsa Dhuli

Drejtor i Përgjithshëm

